Arqil e Peri

Digitally signed by Arqile Peri
Date: 2019.09.11 16:07:11 +02'00'

# RAPORTI TEKNIK

## PROJEKT-ZBATIMI

**Projekt –Zbatimi**

**Emertimi i Objektit: "NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE NË SHKOLLËN 9-VJEÇARE “KOSOVA’’**

**Informacion i Projektit:**

**Investitori:** Bashkia e Tiranes.

**Projektues:** "Zenit & CO" sh.p.k

**Emertesa e Projektit:** "Ndërtim i Terreneve Sportive në Shkollë 9-Vjecare ‘’ KOSOVA’’

**Sherbimi**: Hartim i Projektit

**Qellimet i Projektit:** Ndertim i Fushes, Futbolli, Basketbolli, Volejbolli, Kend Gjimnastike

**Viti i Projektit: Shtator, 2019 Tirane**

**Standartet Projektimit Referuar:** VKM_319_date_12.04.17_standarti_i_projektimit_te_shkollave_1-1

KTP / KTZ / Eurocode / Neufert third edition

**Kapaciteti i Nxenesve:** 240 Nxënës

## 1. Pozicioni Gjeografik i Objektit:

- Shkolla Kosova ndodhet e pozicionuar ne jug-lindje te qytetit te Tiranes, ne nje distance prej 1.5 km nga qendra e qytetit.




## 2. Hyrje dhe Gjendja Ekzistuese:

- Pas analizes se temave te references se detyres se projektimit per objektin : Ndertim i Terreneve sportive ne Shkolle 9-Vjecare ‘’ KOSOVA’’ Tirane. Grupi i punes filloi rikonceptimin dhe inspektimin teknik ne terren te hapesirave per te njohur me nga afer gjendjen ekzistuese dhe percaktuar bazen ku do te zhvillohet projekti. Gjate inspektimit ne terren jane realizuar edhe matjet faktike me instrumentet gjeodezike. Matjet faktive jane bere vetem ne territorin e shkolles dhe ne hapersirat perreth saj. Gjate matjeve me instrument eshte bere azhornimi i infrastruktures inxhinierike si puseta, kuneta kullimi, shtylla elektrike etj.

- **Shenim:** Pasi percaktuam kufirin fizik ne terren dhe perputhjen me cfare eshte kerkuar ne detyren e projektimit rezulton qe hapesira eshte e pamjaftueshme per zhvilluar projektin sipas detyres se projektimit.
- Perimetri faktit ne terren: 880 m². Pas konstatimit dhe kerkeses se bere nga ana jone per konfirmin te sheshit te ndertimit drejtuar Bashkise Tirane rezulton qe njolla e sheshit do te jete me madhe. Duke pare me kujdes njollen e re lind nevoja per nderhyrje dhe prishje te objeteve ekzistuese private gje e cila ngelet te per t’u zgjidhur nga Bashkia.

## 3. Planifikimi i Nderhyrjeve dhe prishjeve te objekteve ekzistuese.

Per te bere te mundur realizimin e projektit sipas kushteve teknike lind nevoja per hapesira shtese.
Nga nderhyrjet ne terriror do te preken 5 objekte ekzistuese te cilat ndodhen ne anen perendimore te shkolles. Pas prishjes se objekteve do te perfitohet nje hapesire prej afro 400 m², hapesire ne te cilen do te vendosen terrent sportive.




Foto te Gjendjes Ekzistuese:







- **Organizimi dhe menaxhimi i hapesirave:**
  Duke pasur parasysh qe hapesirat per kete projekt jane te limituara, eshte marre ne konsiderate qe te behet nje menaxhim sa me mire per te plotesuar nevojat e detyres se projektit.
  Forma e parceles se destinuar per projektin e terreneve sportive do te jete ne forme drejtekendeshe me shtrirje gjatesore nga veriu-jug me brinje me te gjate, dhe lindje perendim me brinje me te shkurter. Projekti Propozon ndertimin e terreneve sportive te kompozuara ne dy fusha dhe nje kendi gjimnastikor.
  Fusha multifunksonale ( Basketbolli dhe Volejbolli) 2 ne 1 te cilat plotesojne standartin dimensional sipas ligjit dhe nje fushe Futbolli e cila do te pershtatet sipas hapesires ne vene ne dispozion. Projekti propozon edhe ndertimin e kendit gjimnastikor e cili ploteson standartin dimensional. Gjithashtu koncepti lejon edhe ruajtjen e hapesires se grumbullimit per nxenesit.
  Dimensioni i Fushave sipas projektit

a) një fushë volejbolli (25.5 x 14 )
b) një fushë basketbolli (25.5 x 14 )
c) kënd gjimnastikor (18 x 8) m

**Shenim:** Projekti parashikon per te gjitha fushat edhe perimtrin e sigurise 100 cm perreth. Perimtri i sigurise eshte hapesira ndermjet vijes se lojes dhe rrethimit.

Propozimi Perfundimtar:

## 4. Dimensionimi I Fushave:

| Detyra Projektimit V-1 | Elementet Kryesore te Projektit | Referuar Standarteve dhe Ligjit |
|---|---|---|
| • **Fushe Multi-Funksionale (27.5 x 16)**<br>• **Fushe Basketbolli**<br>• **Fushe Volejbolli**<br>• **Kend Gjimnastike (18 x 8)** | • Ndertimi i Fushave ne nje Fushe multi-funksionale per shkak te territorit te pamjaftueshem.<br>• Rrethimi me konstruksion metalik dhe rrjete teli e veshur me plastike<br>• Instalimi i shtyllave te ndricimit LED<br>• Ndertimi i infrastruktures per drenazhimnin e ujrave te shiut.<br>• Akses per PAK<br>• Sistemimi i hapesirave qe do te ndikohen gjate projektit<br>• Mobilim urban i hapesirave te prekura nga projekti.<br>• Mbulesa e fushes me rrjete najloni.<br>• Vendosja e Koshave te mbeturinave<br>• Mobilimi i hapesirave me elementet e nevojshme si kosha, stola etj. | VKM_319 Date 12.04.2017<br>Standarti I Projektimit te shkollave.<br><br>**References:**<br>Ernst and Peter Neufert, Architects' Data, Third Edition (Hapesirat sportive ne ambiente te jashtme)<br><br>(KTP) dhe (KTZ) |

**Fushe Multifunksionale-Basketbolli dhe Volejbolli (27.5 x 16 ) Perfshire 1 m hapersire mbrojtje nga rrethimi ne te gjithe perimetrin. Paketa e shtresave:**



## Kend Gjimnastikor: (18 x 8 ) m

Ne kendin e Gjimnastikes do te instalohen 2 struktura per paralele dhe 1 Unaze.

Hapesira e kendit do te jete e sthruar me rere.

**Fushe Multi-funksionale:**

PLANVENDOSJA E TERRENEVE SPORTIVE SH 1:100






**Pamje te Renderuara:**





………………………………………………………………………………………………………………………………**Fund**

**Draftuar: Zenit & CO:**

Ing. Nd: Rexhep TARBA

Ing.Hidro: Merita Mengri

Ark.Rajmonda DAJA

Ing Mjed. Yzeir MIRAKA

Ing.Elek:Spiro PLEQI

Ing Mjed. Kristaq GJOKA

Ing.Mekanik Arqile PERI

Ing.Gjeo:Lulzim VRAPI

**Administratori:**

**Zenit & CO sh.p.k**

**Ing. Arqile Peri**